

## Komentet e KEK-ut lidhur me Raportin Konsultativ të ZRrE-së

Për këto komente, fillimisht paraqitet seksioni nga Raporti Konsultativ i ZRrE-së duke u përcjellë më pas nga komenti i KEK-ut me shkronja të formatit Bold.

### **3. Rregullimi për ndryshimin në mes të shpenzimeve të realizuara dhe atyre të lejuara**

Sipas metodologjisë tarifore të ZRrE-së, nga të licencuarit kërkohet që të realizojnë të gjitha investimet të cilat i'u janë lejuar me tarifën e rregulluara, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre investimeve për Kosovën. Në rast se investimet e lejuara nuk janë realizuar, ZRrE rregullon të ardhurat e lejuara në shqyrtimin që pason, duke zbritur shpenzimet e zhvlerësimit dhe kthimin e lejuar, që shkaktohen nga investimet që janë lejuar por nuk janë realizuar. Ky rregullim është aplikuar për KEK dhe KOSTT. Efekti i këtij rregullimi është reduktimi i të ardhurave të lejuara me përafërsisht €7.9 milion për KEK dhe për një sasi të vogël për KOSTT.

**Komenti i KEK-ut: Është e vështirë që të përcaktohen llogaritjet dhe të vlerësohen rregullimet e bëra nga ZRrE-ja. I lutemi ZRrE-së që të jap llogaritjen e saj për zbritjen prej €7.9 milion për KEK-un dhe të tregoj se sa është një “shumë e vogël për KOSTT-in” (përfshirë po ashtu edhe kalkulimin për këtë çështje të KOSTT-it)?**

**Po ashtu, qëllimi i “rregullimit” është që të përfshihet një KOMPENZIM për konsumatorët në vitin 2009 sepse KEK-u nuk e ka shpenzuar një komponent të kostove të parashikuara për vitin 2008 në aplikimin e mëparshëm tariforë. Nëse ZRrE-ja dëshiron të përdorë rregullimin tariforë RETROAKTIV, atëherë duhet të rregulloj të gjitha elementet e Të Hyrave të Lejuara të vitit 2008 në vlerat e tyre aktuale.**

**Në anën tjetër, nëse është qëllimi që të rregullohet bilanci fillestar i Bazës së Aseteve të Rregulluara në shumën aktuale të datës 01 Janar 2009, atëherë KEK-u do të pajtohej me atë koncept. Prapë, shuma e rregullimit nuk mund të vlerësohet pasi që ZRrE-ja nuk ka dhënë llogaritje mbështetëse.**

**KEK-u dëshiron të qartësoj se njëra nga arsyet që shpenzimet kapitale për vitin 2008 kanë qenë shumë më të ulëta sesa shumat e parashikuara ishte sepse huaja e Qeverisë për pajisjet e mihjes dhe gjenerimit është pritur që të ishte e dispozicion në fillim vitit 2008, duke i lejuar këtu KEK-ut që të bëjë kontraktimin e pajisjeve (rregullat e prokurimit nuk e lejojnë KEK-un që të hap tenderin për pajisje para se të bëhet alokimi i fondeve). Në fakt, ajo hua nuk ka qenë e gatshme deri në çerekun e tretë të vitit 2008, duke i vonuar kështu shumicën e shpenzimeve deri në vitin 2009. Vonesat e prokurimit po ashtu kanë qenë të nënvizuara nga udhëzimet e lëshuara nga Qeveria e Kosovës në Janar 2008, e cila kërkonte që KEK-u t'i suspendoj të gjitha projektet e prokurimit të financuara nga buxheti i Kosovës, deri në njoftimin tjetër. Ky udhëzim po ashtu i është komunikuar edhe organeve tjera kompetente, siç është Agjensioni i Prokurimit Publik, duke e penguar në këtë mënyrë prokurimin e projekteve kapitale kryesore për KEK-un. Ndalesa e Qeverisë nuk është larguar deri në Korrik të vitit 2008.**

Kombinimi i gjërave të cekura më lartë nuk e ka lejuar KEK-un që të hyjë në kontratat për projektet e planifikuara deri kah fundi i vitit 2008, dhe me pagesat fillestare jo më herët se në vitin 2009.

#### 4.1 Kostot e propozuara të importit dhe të eksportit

Duke marrë parasysh këto, dëshmitë në çmimet e EEX sugjerojnë se çmimi mesatar prej 125 €/MWh i parashikuar nga KEK duket të jetë i mbivlerësuar, prandaj ZRrE propozon që çmimi i importit të zbritet në 112.4 €/MWh, që është i njëjtë me çmimin e realizuar të importit për vitin 2008. Kjo sjell një zbritje të të ardhurave të lejuara prej 6.5 milion euro.

##### Komentet e KEK-ut:

1. Parashikimi i KEK-ut për çmimin mesatar të importit në vitin 2009 është i bazuar në çmimet e kontratave që janë në fuqi për muajt Janar deri në fund të Marsit 2009. KEK-u nuk pajtohet me metodën e ZRrE-së që çmimin ta bazoj në çmimin e importit të vitit paraprak, sesa ta bazoj atë në çmimin e kontratës aktuale që është në dispozicion. Bazuar në procesin adekuat të tenderimit konkurrues, KEK-u tani për tani ka nënshkruar kontratat për energjinë e importuar me €125/MWh. Nëse KEK-u i zbaton rekomandimet e ZRrE-së, atëherë KEK-u nuk duhet të importoj gjatë vitit 2009 nëse çmimin është më i lartë se €112.5/MWh edhe nëse nënkupton më shumë ndërprerje në furnizim me energji elektrike?
2. Nëse zvogëlimi në të hyrat e lejuara është €6.5 milion, atëherë ndoshta edhe Bilanci Energjetik duhet që po ashtu të modifikohet për të pasqyruar njëkohësisht zvogëlimin në MWh që janë në dispozicion për shitje, e që kjo më pas do të rezultonte në më pak të hyra, kështu që, zbritja e përgjithshme të cilën ZRrE-ja e propozon për KEK-un është një shumë edhe më e madhe.

#### 4.2 Jetëgjatësia e Supozuar e Aseteve

Ndryshimet e propozuara nga ZRrE mbi jetëgjatësinë e asetëve janë si vijon:

- Rrjeti – zbritje në 35 vjet, duke e barazuar me jetëgjatësinë e supozuar të asetëve të transmisionit, për arsye të konsistencës.

**Komenti i KEK-ut:** KEK-u sugjeron që ZRrE-ja nënkupton “Asetet e Shpërndarjes” e jo “Asetet e Transmisionit”. Jeta mesatare prej 30 viteve e propozuar nga KEK-u, është e bazuar në asetet e Shpërndarjes që në përgjithësi duhet patjetër të zëvendësohen më shpesh sesa asetet e transmisionit. Duke u bazuar në atë se një pjesë e madhe e investimeve të reja të shpërndarjes kanë të bëjnë me njehsorë (që kanë jetë dukshëm më të shkurtër se 30 vite), jeta prej 30 vitesh e propozuar nga KEK-u është shumë me reale sesa 35 vitet që është përdorur për transmisionin.

Kjo rezulton në zbritje prej 2 milion euro të të ardhurave të lejuara për KEK dhe KOSTT.

**Komenti i KEK-ut: Nuk është e qartë se cila pjesë e €2 milion është e KEK-ut dhe cila pjesë i dedikohet KOSTT-it. KEK-u me respekt kërkon informatat lidhur me llogaritjet dhe bazat se si është arritur kjo llogaritje.**

#### **4.3 Humbjet e Lejuara**

Si KEK-u ashtu edhe KOSTT-i kanë kërkuar rritje të humbjeve të lejuara që duhet të mbulohen nga tarifat e rregulluara. KEK ka kërkuar që niveli i humbjeve komerciale të rritet në 22.7% krahasuar me nivelin e lejuar prej 20% në vitin 2008 dhe atë të realizuar prej prej 25.8% në vitin 2008. ZRrE thekson se humbjet në rrjetin e transmisionit dhe distributionit nuk duhet të pësojnë rritje.

#### **Komentet e KEK-ut:**

- 1. KEK-u nuk po kërkon një rritje siç është theksuar në Raportin Konsultativ. Aplikimi tariforë i KEK-ut tregon një zbritje nga aktualitë 2008, e jo nga pjesa e lejuar nga ZRrE-ja; KEK-u ka bërë përparim të qëndrueshëm drejt zvogëlimit të humbjeve jo-teknike. (p.sh Aktualitë 2008 ka qenë 25.8%, kure e kërkuar për 2009 është 22.7%.)**
- 2. ZRrE-ja përshin energjinë e liferuar në enklava në humbjet jo-teknike. Prapë se prapë KEK-u nuk ka kontroll mbi këtë konsum dhe nuk i lejohet nga KFOR-i, që t'i shkyç enklavat e as të hyjë në këto vende. Edhe pse Qeveria e Kosovës dhe KEK-u mbështesin dhe janë të përgatitur që të përfshinë enklavat në proceset normale të matjes, faturimit, inkasimit, dhe shkyçjes, aksionarët ndërkombëtar në mënyrë të shprehur e qortojnë KEK-un që të mos e bëjë një gjë të tillë. Ndihmesa e ZRrE-së në këtë aspekt do të çmohej.**

#### 4.5 Shpenzimet e personelit të KOSTT

Aplikacioni i dorëzuar nga KEK paraqet rritje në numrin total të stafit në 7,899, që është për 365 më shumë sesa numri i lejuar në vitin 2008 dhe 390 më shumë sesa numri i punësuar aktualisht. Është vështirë të kuptohet arsyeshmëria e një ngritjeje kaq të madhe të numrit të personelit. Duke marrë parasysh këtë, ZRrE propozon të mbajë numrin e lejuar të personelit në atë që është aprovuar në vitin 2008<sup>1</sup>. ZRrE po ashtu do të studiojë edhe më tej arsyeshmërinë e nivelit të stafit, posaçërisht duke i krahasuar ato me nivelet e stafit në kompanitë në regjion.

##### Komentet e KEK-ut:

1. KEK-u supozon që ky nën-seksion duhet të jetë për KEK-un, e jo për KOSTT-in.
2. Në përgjigjen ndaj letrës së ZRrE-së në janar 2009, KEK-u ka dhënë një shpjegim për rritjen e numrit të punëtorëve.
3. Vendosja për nivelizimin e stafit është përgjegjësi dhe autoritet i menaxhmentit të KEK-ut. KEK nuk beson se është në autoritetin e ZRrE-së që të caktoj *numrin* e punëtorëve të KEK-ut megjithatë, autoritetit që i është caktuar ZRrE-së është që të vendosë nëse është e arsyeshme shuma e përgjithshme për shpenzimet e rrogave, që është kërkuar nga KEK-u në tarifa.

Kjo rezulton në reduktim prej 2.5 milion euro të të ardhurave të lejuara.

**Komenti i KEK-ut:** Si është llogaritur kjo shumë dhe si ndahet mes KEK-ut dhe KOSTT-it. KEK-u me respekt kërkon llogaritjen e numrave që rezultojnë në zvogëlimin e cekur më lartë.

#### 4.6 Shpenzimet për Materiale dhe Shërbime të Administratës Qendrore

Në aplikacionin përfundimtar, KEK ka kërkuar 3.2 milion euro për shpenzime për materiale dhe shërbime në divizionin e administratës qendrore. Për krahasim, shpenzimet e lejuara për vitin 2008 në këtë kategori kanë qenë 0.6 milion euro, dhe janë realizuar rreth 1 milion euro.

Një rritje kaq e madhe e shpenzimeve të kërkuara duket e paarsyeshme. Siç është bërë me kostot e kërkuara të mirëmbajtjes të KOSTT, ZRrE do të lejojë një shumë që është përafërsisht e barabartë me mesataren e shpenzimeve të realizuara të vitit 2008 dhe ato të kërkuara të vitit 2009. Kjo paraqet reduktim prej 1.1 milion euro nga të ardhurat e lejuara.

**Komenti i KEK-ut:** KEK-u nuk pajtohet me këtë zvogëlim të propozuar. Në përgjigjen e tij ndaj letrës së ZRrE-së në Janar 2009, KEK-u ka dhënë një shpjegim për rritjet në shpenzimet e Administratës Qendrore e kjo për shkak të përmirësimeve të mëdha në objektet (rrjetet kryesore) dhe mundësit e TI-së, (personeli kryesorë i aftësuar për të menaxhuar rrjetet, bazat e të dhënave dhe aplikimet softuerike), që kanë

---

rezultuar në menaxhimin më të mirë të KEK-ut zvogëlimin e përdorimit të shërbimeve të jashtme, dhe në zvogëlimin e humbjeve.

#### **4.7 Borxhet e këqija dhe kapitali punues**

Aplikacioni i dorëzuar nga KEK përmban kërkesën për lejimin e 3.2 milion euro për borxhe të këqija dhe 0.7 milion euro për kosto të financimit të kapitalit punues përmes të kredive afatshkurtra. Në pajtueshmëri me metodologjinë tarifore dhe vendimet e mëparshme, ZRrE propozon të mos lejojë asnjërin nga këto kosto. Është vendosur më parë që kostot e humbjeve në faturim, duke përfshirë edhe borxhet e këqija, nuk duhet të mbulohen nga konsumatorët që paguajnë faturat e tyre. Sa i përket koston së kapitalit punues, ZRrE tashmë lejon marzhën e furnizimit që përfshinë mbulimin e këtyre kostove.

Kjo rezulton në reduktim prej 3.9 milion euro të të ardhurave të lejuara.

##### **Komentet e KEK-ut:**

1. KEK-u nuk pajtohet me moslejimin e borxhit të keq. Edhe kompanitë e energjisë elektrike që janë më së miri të menaxhuara në botë, kanë borxhe të këqija dhe rregullatorët lejojnë një pjesë të vogël (zakonisht më pakë se 2%) nga shuma e të Hyrave të Lejuara që ta reflektojnë këtë. Metodologjia tarifore e ZRrE-së është jashtë rendit të praktikave të pranuar ndërkombëtarisht sa i përket kësaj çështje.
2. Sa i përket Kapitalit Punues, KEK-u dhe ZRrE-ja nuk kanë ndonjë mosmarrëveshje bazë, përveç përdorimit të termit "Kapitali Punues". KEK-u në aplikimin e tij ka përfshirë një shumë specifike me interes afatshkurtër prej €700,000 si shumë të lejuar për kapitalin punues, një shqyrtim i modelit të ZRrE-së për procesin tariforë 2008 tregon se ZRrE-ja ka lejuar kapitalin punues duke përfshirë €5 milion në Bazën e Aseteve të Rregulluara. Natyrisht, metoda e ZRrE-së nxjerrë një shumë prej €690,000 (€5,000,000 x 13.8%) krahasuar me kërkesën e KEK-ut prej €700,000.
3. KEK-u dëshiron të thekojë se Metodologjia Tarifore e ZRrE-së (Seksioni 3.6) thekson se "Margjina e furnizimit e kompanisë Furnitorin Publik për rrezikun që e merr". Nuk do të thotë se margjina e furnizimit është për kapitalin punues

## 5 Përmbledhje e të ardhurave të lejuara

Pas këtyre rregullimeve, ZRrE propozon rritje të të ardhurave të lejuara prej 2.5% për vitin 2009, krahasuar me nivelin e kërkuar prej 18.3% të kërkuara nga KEK dhe KOSTT.

**Komenti i KEK-ut:** KEK-u dëshiron të theksoj se rritjet në të Hyrat e Lejuara nuk janë në proporcion direkt me rritjet në tarifa, përveç në rastin ku shitjet për secilën kategori tarifore janë saktësisht të njëjta në secilin vit.

**Tabela 1: Përshkrim i të ardhurave të lejuara**

Te ardhurat nga Tarifat e Rregulluara		2008	2009	2009	2009
		Lejuar	Kerkuar	Korrigjuar	Propozuar
KEK (Nuk përfshihen ndër-pagesat / Përfshihen kostot e AQ)					
Minierat	€000	46,324	59,397	53,506	50,309
Gjenerimi	€000	37,692	41,953	43,404	42,226
Rrjeti	€000	24,298	24,823	24,832	23,446
Furnizimi	€000	16,866	22,062	21,776	12,108
<b>Gjithsejtë</b>	€000	<b>125,180</b>	<b>148,235</b>	<b>143,517</b>	<b>128,089</b>
KOSTT (nuk përfshihen ndër-pagesat)	€000	11,290	13,251	13,223	11,828
<b>Gjithsejtë</b>	€000	<b>136,469</b>	<b>161,486</b>	<b>156,740</b>	<b>139,917</b>
Ndryshimi nga të ardhurat e lejuara 2008			18.3%	14.9%	2.5%

### Komentet e KEK-ut:

1. KEK-u sugjeron që krahasimi në mes të Të Hyrave të Lejuar për vitin 2008 dhe Të Hyrave të Kërkuara për vitin 2009 mund të jetë deri diku i keq orientuar, në veçanti nëse rriten shitjet; siç është cekur më herët, nuk ka lidhshmëri të përbashkët direkte në përqindje mes Të Hyrave të Lejuara dhe Çmimeve. Kjo do të ndodhte vetëm nëse shitjet në secilën prej kategorive të konsumatorëve janë identike për të dy vitet.
2. Shuma e kërkuar në tabelën për Divizionin e Furnizimit nuk është në përputhje me shumën të cilën e ka dorëzuar KEK-u, e cila ishte € 36,842 dhe ka përfshirë € 15,000 për pagesën e KOSTT-it. Zbritja e pagesës për KOSTT-in (e paraqitur veçmas në tabelë) rezulton në kërkesën e Divizionit të Furnizimit prej € 21,842.
3. Është vështirë të përcaktohet dhe të vlerësohet se si ZRrE-ja i ka bërë të gjitha llogaritjet e përfshira në tabelë. I lutemi ZRrE-së nëse mundet të jap hollësitë e llogaritjeve për shumën e kolonës të "2009 të Korrektuar" dhe shumën e kolonës "2009 të Propozuara"? Po ashtu pasi që kolona "2009 të Kërkuara" nuk pajtohet me atë që ka dorëzuar KEK-u, ju lutemi të na jepni bazën për €161,486,00 në tabelën më lartë.

## 6. Rregullimet e Propozuara Tarifore

Aplikacioni i pranuar nuk propozon ndryshime në strukturën e tanishme tarifore, edhe pse KEK ka propozuar një mënyrë të kalkulimit të tarifës që reflekton kostot për grupet e konsumatorëve, që ndryshon nga mënyra e kalkulimit të ZRrE-së. ZRrE planifikon të shqyrtojë këtë metodologji tarifore në mënyrë të detajuar para shqyrtimit të ardhshëm tarifor.

### Komenti i KEK-ut:

1. Nuk është e qartë se çfarë nënkuptohet me "një mënyrë alternative" KEK-u ka dorëzuar Aplikacion Tariforë bazuar në modelin e vet tariforë që është në përputhje me Metodologjinë Tarifore dhe Rregullën për Caktimin e Çmimeve, të ZRrE-së. Duket se ZRrE-ja po i përziehen proceset e dalluara (1) alokimin e kostove nëpër klasat e konsumatorëve, dhe (2) Dizajnin Tariforë. "Strukturat Tarifore" lidhur me tarifat e konsumatorëve është dizajnuar duke përdorur një përzierje të ngarkesës së konsumatorit, dhe ngarkesat e energjisë (duke përfshirë kohën e përdorimit dhe bllok strukturat).
2. KEK-u e interpreton këtë se nënkupton që ZRrE-ja nuk do ta marrë në konsideratë propozimin e KEK-ut për të lëvizur drejt tarifave që të reflektoj më shumë kostot deri në aplikimin e ardhshëm tariforë në 2010? Nëse po, KEK-u nuk pajtohet. ZRrE-ja ka theksuar disa herë se qëllimi i saj është që gradualisht të lëvizë drejt tarifave që reflektoj kostot. Nuk ka ndonjë kontestim se tarifat e amvisërisë janë duke e rregulluar dukshëm më pak sesa kostot për t'i shërbyer ato. Siç duket ZRrE-ja nuk është ende e përgatitur që të marrë qëndrimin politik jo të popullarizuar, që të lëvizet drejt tarifave që reflektojnë kostot.
3. KEK-u dëshiron të theksoj se ZRrE-ja ka cekur në letrën e saj 01. Dhjetor 2008 "Shqyrtimin e Tretë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHT<sub>3</sub>) – Parimet dhe Orari" nën seksionin e titulluar "Parimet e Aplikimit" se "*Do të ketë një lëvizje graduale drejt tarifave që reflektojnë kostot*" KEK-u beson se Aplikimi i tij Tariforë përputhet me këtë politik dhe propozon që të lëvizet drejt tarifave që më shumë reflektojnë kostot.

ZRrE propozon që është korrekte të ngritën të gjitha tarifat me të njëjtën vlerë, përderisa është duke studiuar metodologjinë e propozuar të vlerësimit të tarifave që reflekton kostot të dorëzuar nga KEK. ZRrE do të vazhdojë të shqyrtojë metodologjitë e ndryshme të alokimit të kostos dhe mund të bëj ndryshime në këtë propozim para se të marrë vendimin për tarifat përfundimtare.

**Komenti i KEK-ut:** KEK-u do dëshironte ta shqyrtonte këtë analizë të ZRrE-së dhe të jap komete, para se ZRrE—ja të marrë vendimin përfundimtar. Ne me respekt kërkojmë që orari i ZRrE-së për t'ia lejuar KEK-ut dhe të tjerëve që ta shqyrtojnë këtë analizë, të jepet sa më shpejtë që është e mundur ashtu që komentet të jepen me kohë.

Në vlerësimin e përcaktimit të tarifës që kërkohet për të arritur të ardhurat e lejuara, është e nevojshme të vlerësohet ndryshimi i vëllimit të shitjeve të energjisë. ZRrE konsideron se është një nivel i lartë i pasigurisë mbi vëllimin e shitjeve në këtë vit, kur merret parasysh kriza ekonomike, nuk pritët të ketë rritje të madhet e vëllimit të energjisë së shitur.

Bilancet energjetike të pranuar janë parashikime nga KEK dhe KOSTT, për të cilat ZRrE konsideron se vëllimi i shitjes nuk paraqet situatë të pritshme reale.

#### **Komenti i KEK-ut:**

- 1. Mesa ka kuptuar KEK-ut, përveç se nga KEK-u dhe KOSTT-i, Bilanci Energjetik po ashtu është pranuar edhe nga Ministria e Energjisë. Gjithmonë ka pasiguri me sasi të shitjeve të parashikuara, megjithatë, për qëllimet e caktimit të tarifave duhet të përdoren sasi të shitjeve të parashikuara. Përndryshe, shumica prej elementeve tjera të kostos për KEK-un dhe KOSTT-in do kishin nevojë që të modifikoheshin për të pasqyruar këtë ndryshim para se të caktoheshin çmimet e tarifave.**
- 2. Po ashtu ekzistojnë forca ekonomike që e shtynë lartë ekonomin Kosovare dhe konsumin e energjisë. Tani që Kosova është e pavarur, po investohen fonde për bizneset dhe ndërtimet në Kosovë. Po ashtu, KEK-u dhe Qeveria e Kosovës janë të zotuar që të furnizojnë me energji të gjithë ata konsumatorë të cilët paguajnë për të. Mundësia e mihjes dhe e gjenerimit të KEK-ut po rritet ç'është muaj dhe veç janë duke u bërë investime që edhe më tutje të rritet furnizimi me energji elektrike për popullin e Kosovës.**

Duke u bazuar në shqyrtimin e tërësishëm të aplikacionit, pas rregullimeve dhe korrigjimeve të bëra, ZRrE propozon që rritja e tarifave të jetë e njëjtë me rritjen e të ardhurave të lejuara të propozuar nga ZRrE (apo në mesatare 2.5% për të gjitha tarifatat).

**Komenti i KEK-ut: KEK-u nuk beson se ky konkluzion është i saktë. Siç theksohet në pikën 5, më lartë tarifatat (çmimet) nuk ndryshojnë në lidhje të drejtpërdrejt si Të Hyra të Lejuara vetëm nëse shitjet për secilën kategori tarifore janë saktësisht të njëjta në të dy vitet (2008 dhe 2009)**

ZRrE do të vazhdojë të vlerësojë bilancin e propozuar energjetik, i cili përfshinë ndryshimet e reduktimit të prodhimit të Ferronikelit, dhe mund të bëjë rregullime të këtij shqyrtimi para se të merret vendimi përfundimtar për tarifatat e vitit 2009. Gjatë vitit 2010, ZRrE do të shqyrtojë dhe rregullojë të ardhurat e lejuara për mbi-mbulim apo nën-mbulim të të ardhurave të lejuara që mund të rezultojnë nga ndryshimet në mes të vëllimeve të realizuara dhe atyre të lejuara të shitjes së energjisë elektrike<sup>2</sup>.

#### **Komentet e KEK-ut:**

- 1. Ju lutemi shikoni më lartë komentet në rregullimet e mundshme në Bilancin Energjetik.**
  - 2. Sa i përket deklaratave që propozon ZRrE-ja për shqyrtimin dhe lejimin e rregullimeve në të hyra gjatë vitit 2010. KEK-u supozon se ZRrE-ja nënkupton se kjo do të ndodhë gjatë aplikimit tariforë vjetorë në 2010, a është kjo e saktë. Nëse jo, ju lutem shpjegoni.**
-